

**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese – Dega Shqipëri**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
**Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 17

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Rawafed AL – Torok Ndërmarrje kontraktuese

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Rawafed AL – Torok Ndërmarrje kontraktuese** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

#### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuoidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

#### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë **Rawafed AL – Torok Ndërmarrje kontraktuese** për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 nuk janë audituar nga ndonjë auditues tjetër.

15 mars 2017

  
Luan Kamberi  
Auditues Ligjor



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	31,422	77,053
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	227,713,152	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	-	10,000
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	151,737,899	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>379,482,473</b>	<b>87,053</b>
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktivët afatgjatë materiale	8	79,000	-
<b>Totali i aktiveve afatgjatë</b>		<b>79,000</b>	<b>-</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>379,561,473</b>	<b>87,053</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	9	171,965,579	12,000
Detyrime tatimore	10	2,219,542	6,138
Parapagime të marra	11	191,077,291	-
Të tjera detyrime	12	12,565,451	137,608
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>377,827,863</b>	<b>155,746</b>
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Hua afatgjatë		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjatë</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>377,827,863</b>	<b>155,746</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar		-	-
Fitime të mbartura		(68,693)	-
Fitimi i ushtrimit		1,802,303	(68,693)
<b>Totali i kapitalit</b>	13	<b>1,733,610</b>	<b>(68,693)</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>379,561,473</b>	<b>87,053</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Performancës**

**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14 199,639,535	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15 981,244	-
<b>Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>	<b>(187,688,785)</b>	<b>(12,675)</b>
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	16 (185,454,692)	-
2) Të tjera shpenzime	17 (2,234,093)	(12,675)
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>18 (10,838,623)</b>	<b>(56,022)</b>
1) Paga dhe shpërblime	(9,229,223)	(45,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	(1,609,400)	(11,022)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19 (480)	-
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>15,428</b>	<b>4</b>
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	20 15,428	-
2) Shpenzime të tjera financiare	-	4
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>	<b>2,108,319</b>	<b>(68,693)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>(306,016)</b>	<b>-</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	21 (306,016)	-
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë	-	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>	<b>1,802,303</b>	<b>(68,693)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>1,802,303</b>	<b>(68,693)</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Fitimet/(humbjet) e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni më 1 janar 2015</b>	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-
Fitimi / Humbja e vitit	(68,693)	(68,693)	(68,693)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Tranferim në fitim humbje të mbartura	(68,693)	68,693	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(68,693)</b>	-	<b>(68,693)</b>
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:</b>	-	-	-
Fitimi / Humbja e vitit	-	1,802,303	1,802,303
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(68,693)</b>	<b>1,802,303</b>	<b>1,733,610</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Rawafed AL- Torok Ndërmarrje Kontraktuese më \_\_\_\_ mars 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.

  
Hajrtes

Hajrtes

  
Z. Al Massad Saleh

Administrator



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	1,802,303	(68,693)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare		-
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		(6)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	276,016	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(227,703,152)	(10,000)
Rënie/(rritje) në shpenzime të shtyra	(151,737,899)	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	186,318,810	155,752
Rritje/(rënie) në të ardhurat e shtyra	191,077,291	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>33,369</b>	<b>77,053</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(79,000)	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(79,000)</b>	<b>-</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua të arkëtuara	-	-
Dividendë të paguar	-	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>(45,631)</b>	<b>77,053</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	77,053	-
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>31,422</b>	<b>77,053</b>
<b>4</b>		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare





**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lekë)*

**1. Informacion i përgjithshëm**

Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese – Dega Shqipëri është krijuar më 15/10/2015 dhe është degë e shoqërisë së huaj si formë ligjore.

Shoqëria shërben si një kontraktues i përgjithshëm për ndërtesa, mirëmbajtje, shërbime sanitare, ndërtime e rinovime, punime në rrugë etj.

NIPT-i i Shoqërisë është L52215010Q. Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën “Asim Vokshi”, njësia bashkiake nr.9, Tiranë.

Në 31 dhjetor 2016 shoqëria kishte 33 punonjës.

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

**2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Vlerat janë në Lekë)*

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

**2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

**3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetarë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Euro/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	128.17	125.79

**3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.



*(Vlerat janë në Lekë)*

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali themeltar*

Shoqëria është degë e një shoqërie të huaj dhe nuk ka kapital të regjistruar.



(Vlerat janë në Lekë)

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lekë)

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.


**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

**3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

#### 3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

#### 3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### 3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### 3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lekë)

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	<b>20,104</b>	<b>3,359</b>
Në lekë	6,413	1,300
Në monedhë të huaj	13,691	2,059
Mjete monetare në arkë	11,318	73,694
Likuiditete në udhëtim	-	-
	<b>31,422</b>	<b>77,053</b>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë	227,713,152	-
	<b>227,713,152</b>	<b>-</b>

**6. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Tatimi mbi fitimin	-	10,000
	<b>-</b>	<b>10,000</b>

**7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime të shtyra	151,737,899	-
	<b>151,737,899</b>	<b>-</b>



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lekë)

**8. Aktive afatgjata materiale**

Aktivitet afatgjata materiale detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Makineri dhe pajisje pune	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendja më 1 janar 2015	-	-
Shtesa	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Shtesa	79,000	79,000
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>79,000</b>	<b>79,000</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
Gjendja më 1 janar 2015	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Amortizimi i vitit	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>		
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>79,000</b>	<b>79,000</b>

**9. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë	171,965,579	12,000
	<b>171,965,579</b>	<b>12,000</b>





**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lekë)

**10. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	270,264	6,138
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	14,300	-
Tatimi mbi fitimin	276,016	-
TVSH për t'u paguar	1,658,962	-
	<u><b>2,219,542</b></u>	<u><b>6,138</b></u>

**11. Të ardhura të shtyra**

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paradhënie klientëve	191,077,291	-
	<u><b>191,077,291</b></u>	<u><b>-</b></u>

**12. Të tjera detyrime**

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime për paga	1,939,501	37,608
Te tjera detyrime	10,625,950	100,000
	<u><b>12,565,451</b></u>	<u><b>137,608</b></u>

**13. Kapitali themeltar**

Shoqëria është degë e një shoqërie të huaj dhe nuk ka kapital të regjistruar.  
 Humbjet e mbartura paraqiten në vlerën 68,693 leke.

**14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga shitja e punimeve dhe shërbimeve	199,639,535	-
	<u><b>199,639,535</b></u>	<u><b>-</b></u>



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lekë)

**14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)**

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
Qarkullim i tatueshëm	390,716,826
Shtohet parapagimet e marra	(191,077,291)
<b>Shuma e qarkullimit të korrigjuar</b>	<b>199,639,535</b>
Sipas Kontabilitetit	199,639,535
<b>Diferenca</b>	<b>-</b>

**15. Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Të ardhura nga këmbimet valutore	981,244	-
Të ardhura të tjera	-	-
	<b>981,244</b>	<b>-</b>

**16. Lënda e pare, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera**

Lënda e pare, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Mallra e aksesore	368,542	-
Trajtime të përgjithshme	185,086,150	-
	<b>185,454,692</b>	<b>-</b>

**17. Shpenzime të tjera**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzime qeraje	144,000	12,000
Sigurime	1,266,734	-
Shërbime bankare	641,506	-
Taksa të ndryshme	67,620	-
Shpenzime të tjera	114,233	-
	<b>2,234,093</b>	<b>12,675</b>



**Rawafed AL – Torok Ndërmarrje Kontraktuese**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lekë)

**18. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	9,229,223	45,000
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,609,400	11,022
	<b>10,838,623</b>	<b>56,022</b>

**19. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjoha dhe dëmshpërblime	480	-
	<b>480</b>	<b>-</b>

**20. Shpenzime financiare (neto)**

Shpenzimet financiare neto detajohetn si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga interes	15,428	4
	<b>15,428</b>	<b>4</b>

**21. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>2,108,319</b>	<b>(68,693)</b>
Total shpenzime të panjohura	480	-
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>2,108,799</b>	<b>(68,693)</b>
Humbje fiskale e mbartur	(68,693)	-
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>2,040,106</b>	<b>-</b>
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>(306,016)</b>	<b>-</b>
	<b>1,802,303</b>	<b>(68,693)</b>

**22. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

